



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.386/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj - kryesues, Bujar Muzaqi dhe Kymete Kicaj - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga kandidati për Kuvendin e Komunës së Fushë Kosovës, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetvendosje (LVV), Vlonjat Hasani, të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 01/3093-2025 të datës 03.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Kuvendet Komunale, të mbajtura në 12 Tetor 2025, me datë 05.11.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZL.Anr.386/2025, datë 04.11.2025, e parashtruar nga kandidati për Kuvendin e Komunës së Fushë Kosovës, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetvendosje (LVV), Vlonjat Hasani, të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 01/3093-2025 të datës 03.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Kuvendet Komunale, të mbajtura në 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datën 04.11.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën e kandidatit për asamble komunale në Komunën e Fushë Kosovës, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetvendosje, Vlonjat Hasani, me të cilën pretendon se sipas informacioneve konkrete të komisionerëve dhe vëzhguesve nga vendvotimi në Miradi të Epërme, 0910, SH.F.M.U. “Vëllëzërit Frashëri” konkretisht 0910/1, pas hapjes së kutive, komisionerë dhe vëzhguesit kanë identifikuar dhe numëruar 80 vota të vlefshme me numrin 4 të subjektit politik LVV. Pas numërimit në Qëndren Komunale të Numërimit evidentohen vetëm 65 vota për numrin 4 të LVV në vendvotimin 0910/1, duke e dëmtuar me 15 vota. Ky gabim e kishte penalizuar dhe dëmtuar, duke i mohuar ose pamundësuar fitimin e ulsës në kuvendin komunal të Fushë Kosovës për 1 votë. Me tujte thekson se gabim ka pasur edhe me votat nga diaspora, të ardhura nga Zvicra. Dyshime tjera pretendon se ka pasur gabime edhe në qendra tjera si 0906-Sh.F.M.U. “Vëllëzërit Frashëri”, Miradi e Epërme, 0906/01 dhe 0906/02, 0916 Sh.F.M.U. “Zejnel Salihu”, 0916/01 dhe 0916/02.

Në përgjigjen në ankesë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me datë 04.11.2025, ka theksohet se bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Procedura e Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar më 01.10.2025, Nr.01/2601/2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN.

Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr.16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN). Andaj, bazuar në Rregullën Zgjedhore Nr.13/2024 Rezultatate Zgjedhore sipas dispozitës së nenit 9 paragrafi 1 thekson se: Në rast të mospërputhjes së rezultateve, KQZ-ja mund të urdhëroj rinumërimin e votave të cilit do VV, ose edhe përsëritjen e votimit në një VV apo QV.

Me tutje, KQZ deklaroi se procesi i numërimit të votave në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) është zhvilluar në përputhje me Rregulloren Zgjedhore Nr. 14/2024, Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) ku ekipet e numërimit kanë bërë numërimin e votave të kandidatëve në transparencë të plotë, ku fletëvotimi është prezantuar në ekran dhe është parë nga vëzhguesit e akredituar.

Bazuar në nenin 17 të Rregullores Zgjedhore nr. 17/2024 për Regjistrimin dhe Votimin Jashtë Kosovës parashihet numërimi i fletëvotimeve të dërguara me postë, sipas të cilës: *17. Fletëvotimet që janë dërguar përmes postës dhe fletëvotimet që janë hedhur në kutitë e votimit nga procesi i votimit në përfaqësinë diplomatike, numërohen në QNR.*

Ndërsa në nenin 20 të Rregullores Zgjedhore nr. 14/2024 për Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, parashihet procedura e numërimit të fletëvotimeve në QNR, përkatësisht në paragrafin 9 të nenit 20 parashihet se: *Zarfet e votimit me postë hapen dhe numërohen pas përfundimit të krahasimit të listave votuese të përcaktuara në nenin 18 të kësaj rregullore si dhe pas përfundimit të numërimit të votave në përfaqësi diplomatike.*

Në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP, gjatë shqyrtimit të ankesës është vërejtur se pala ankuese, po ashtu nuk ka bashkangjitur prova relevante, që do të mund të dëshmonin apo mbështesnin pretendimet e tij.

KQZ, ju njofton se i gjithë materiali zgjedhor duke përfshirë edhe kamerat e sigurisë, pas përfundimit të gjithë procesit të punës së QKN i njëjti material zgjedhor dorëzohet nga QKN në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve -QNR, dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet drejtësisë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë gjeti se:

- Ankesa është e pa bazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjeve në ankesë të paraqitur nga KQZ-ja, vlerësoj se pretendimet e ankuesit, kandidati për asamblë komunale në Komunën e Fushë Kosovës, nga radhët e subjektit politik LVV, Vlonjat Hasani, janë të pa qëndrueshme dhe të pa bazuara. Fillimisht Paneli vlerësoi se parashtruesi i ankesës nuk ka parashtruar as edhe një provë të vetme lidhur me pretendimet e paraqitura në ankesë, edhe pse i njëjti i referohet si informacione konkrete nga komisionarët dhe vëzhguesit mirëpo në ankesë nuk paraqet asnjë provë lidhur me këto informacione konkrete përveç se i paraqet emrat dhe mbiemrat dhe nr. e telefonit të një komisioneri dhe një vëzhguesi pa ndonjë provë konkrete zyrtare lidhur me pretendimet e tija në ankesë. Po ashtu edhe sa i përket pretendimeve në ankesë se gabim ka pasur edhe me votat nga diaspora, të ardhura nga Zvicra, si dhe dyshime tjera se ka pasur gabime edhe në qendra tjera si 0906-Sh.F.M.U. “Vëllëzërit Frashëri”, Miradi e Epërme, 0906/01 dhe 0906/02, 0916 Sh.F.M.U. “Zejnel Salihu”, 0916/01 dhe 0916/02 nuk ka ofruar asnjë provë të vetme lidhur me këto pretendime vetëm

duke paraqitur si të përgjithësuara pretendimet e tija ankimore, prandaj Paneli si të tilla i refuzoj për faktin se nga veprimet e përshkruara si në ankesë se ka mospërputhje të numrit të votave të publikuara me numrin real të votave, paneli nuk ka arritur që të vërtetoj se ka pasur shkelje apo parregullsi për të cilat pala ankuese pretendon me ankesën e tij, kjo pasi që paraqitësi i ankesës nuk ka bashkangjitur ankesës prova me të cilat do të argumentonte pretendimet e tij se i mungojnë votat, ndërsa pretendime e theksuara në ankesë tani për tani mbeten në nivel të supozimit nga se nuk janë argumentuar me fakte dhe në prova konkrete.

Paneli, vlerësoi se ankesa është e pabazuar dhe e pa argumentuar, pasi që parashtuesi i ankesës nuk ka bashkangjitur prova bindëse, që do të mund të dëshmonin apo mbështesnin pretendimet e tij. Pra, nuk ka bashkangjitur libër të votimit në vendvotim dhe QKN, formularë, ose prova të tjera që do të mund të mbështesnin pretendimet e tij.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtuesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse. Andaj, duke u mbështetur në nenin 117 paragrafi 3 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nën përcaktohet se *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar në nenin 117 paragrafi 3, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZL.Anr.386/2025 më datën 05.11.2025

Kryesues i Panelit
Skender Çoçaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.